



REPUBLIKA E SHqipërisë

**BASHKIA PATOS**  
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot .

Patos, më 11/04/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kontenier për grumbullimin e mbetjeve urbane”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

KODI CPV Kontejner dhe kazanë për mbeturina dhe plehra 34928480-6

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1,666,600 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë** pa TVSH, vënë në dispozicion nga Të ardhurat lokale 2023

Kjo procedurë zhvillohet në përputhje me pikën b të nenit 58 dhe nenin 67 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” ku Bashkia Patos është organi të cilit i është deleguar e drejta e kryerjes së procedurës të prokurimit nga për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2020, 2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **666,640 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë)** lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

**1,666,600 x 40% = 666,640 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë)** lekë.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim:* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2020 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e

aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

**1,666,600 x 20% = 333,320** treqind e tridhjetw e tre mijw e treqind e njwzetw Lekë.

---

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet e mëposhtme:

- Kamion me karroceri (për transportin e kontenierëve) copë 1 (një)
- Autovinxh (për të kryer ngarkim shkarkim) copë 1 (një)

---

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit,
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
  - fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e

objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të realizuar transportin, operatori ekonomik fitues duhet të ketë një mjet autovinxh për ngarkim shkarkim dhe një automjet me karroceri për transportin e kontinierëve.

2.3.3. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që garancia e mallrave do të jetë 1 (një) vit nga momenti i marrjes në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe se marrin përsipër furnizimin e mallit në destinacionin e kërkuar dhe brenda afatit të levrimit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

**ARGUMENTIM:** Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.4. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin 1 (një) kontenier (sipas specifikimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor) si mostër, pranë Magazinës së Bashkisë Patos brenda datës 24/04/2023 ora 11:00, para hapjes së vlerësimit nga K.V.O. përkatëse. Kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor Për rëndësinë e mallrave objekt prokurimi ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave (me qëllim testimin e kontinierit në mjetin teknologjik të Agjencisë së Shërbimeve Publike Patos, për të parë përpuethshmërinë dhe funksionalitetin në mjet).

Shënim: Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e paraqitura nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në preventiv. Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat do të kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në 6 pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: *6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo*

gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

- Kapaciteti mbajtës (vëllimi) i kontinierëve duhet të jete 1100 litra per cope.
  - Pesha mbajtëse e kontinierit të jete jo me e vogel se 500 kg per cope.
  - Te gjithë kontinieret të jene standart, me keto permasa: gjatesia = 1200 m/m ; gjerësia 960 m/m; lartësia 1200 m/m duke perfshire edhe harkun anesore.
  - Materjali që do të perdoret per prodhimin e tyre të jete llamarine xingato e galvanizuar.
  - Ne te kater anet llamarine e kontinierit të jete e kalandruar e me damar per te rritur qendrushmerine e kontinierit.
  - Lllamarina të jete me spesor jo me te vogel se 2m/m.
  - Bashkimit i elementeve metalik të realizohet me saldimit tegel të panderprere, nuk pranohet varjanti me pikime të nderprera .
  - Rrotat të jene të veshura me gome mishi dhe me suport llamarine me diameter 200m/m
  - Suportet per fiksimin e rrotave të jene llamarine me trashesi jome të vogel se 5m/m
  - Nyjet e rrotave të jene me kushineta dhe lehtesisht të manovrushme (të rrotullueshme 360°)
  - Pjesa fundore e kontinieri të jete në forme ovale e perforcuar me element të tjere dhe rezistente ndaj shtypjeve gjate manovrimit.
  - Dorezat të jene metal i rrumullaket dhe të salduara mire në faqet ballore.
  - Kontinieri në faqet ballore të kete kater shiritat fosforishente per paralajmerime natën.
  - Per të relizuar pa pengese manovrimin, dy faqet anesore të kontinierit të jene me hark.
  - Në krahun ballor, në pjesën anesore, të saldohen dy element në forme trapezoidale me dimesione gjatesia 500m/m gjerësia 50m/m lartësia 30m/m e cila do të shërbejë për perforcime e mbeshtetje gjate shkarkimit të kontinierit në makinën teknologjike.
  - Faqet ballore kontinieret të jene të stampuar me logon e Bashkise Patos dhe mbishkrimin “Bashkia Patos- Nd/ja e Pastrim-”.
  - Kontinieri (koshi) të jete rezistent ndaj kushteve klimatike, kimikateve, dhe zjarrit.
  - Garancia e çdo kontinieri do të jetë një vit (parjashtohen raste kur dëmtimi nuk vjen si shkak i cilësisë së dobët)
  - Dorëzimi i kontinierëve do të bëhet në Agjencinë e Sherbimeve Publike.
- Specifikimet teknike janë bere për permbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor. Në zbatim të prioriteve në Programin e bashkise është rritja e standarteve bashkekohor të pastrimit si dhe të

masave parandaluese per perhapjen e pandemise e cila do te jete prezent per nje kohe relativisht te gjate .Eshte domosdoshmeri qe te marrim masa ekstra edhe ne trajtimin e mbetjeve urbane dhe ne pastrimin e qytetit. Shtimi i konteniervave eshte i nevojshem per te mundesuar trajtimin e mbetjeve brenda kushteve higjeno/sanitare dhe per te realizuar evadimin e tyre sa me shpesh em qellim qe te shmangim ndotjet te cilat behen shkak per shtimin e insekteve qe perhapin mikrobe te cilat behet shkak per shtimin e insekteve qe perhapin mikrobe te cila jane potencial per perhapje te semundjeve te ndryshme.Kerkese tjeter eshte dhe kryerja e investimeve dhe rikonstrukcioni I rrugeve dhe lulishteve te reja ne te cilat nuk mund te sherbehet me pika fikse por kerkon vendosjen e koteniereve te rinj. Rritja e kerkesave per sherbime te pastrimit dhe evadimit te mbetjeve ne Njesite Administrative Zharres dhe Ruzhdie, rritja e volumit te mbetjeve si dhe rritja e kerkeses per cilesi me te mire sherbimi kane shtuar nevojën per kontinier te rinj me specifikimet e mësipërme. Demtimi dhe nxjerrja jashte funksionit i disa kontinierëve egzistues bene te domosdoshem zevendesimin e tyre.Synimi per te rritur nivelin e sherbimeve dhe per te futur gradualisht standartizimin e sherbimeve te pastrimit dhe ndarjen e mbetjeve shton nevojën per shtimin e konteniervave dhe dendesimin ne pjesen me te madhe te pikave ekzistuese e cila do te sherbej si nje mase paraprake per ndarjen e mbetjeve urbane.Grumbullimi i mbetjeve,shkarkimi i tyre ne Inceneratorin Fier eshte nje tjeter arsye per te shtuar numrin e konteniervave me qellim qe tu pergjigjemi kerkesave per kete sherbim. dhe Kompletimi i Agjencise se Sherbimeve Publike me dy makina teknologjike krijon mundesine per te kaluar gradualisht nga pikat fikse prej betoni e ngarkimi me krahe ne vendosjen e konteniervave dhe kalimin ne kryerjen e mekanizuar te proceseve te punes duke patur domosdoshmeri paisjen me konetenier me specifikimet e kerkuara pasi mjetet jane ekzistuese dhe ky tip kontenieri eshte I pershtatshmi. Synimi per te rritur nivelin e sherbimeve dhe per te futur gradualisht standartizimin e sherbimit te pastrimit dhe ndarjen e mbetjeve shtron nevojën per shtimin e konteniervave dhe dendesimin ne pjesen dermuese te pikave ekzistuese.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **24/04/2023, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje bazë materiale grumbullimin e mbetjeve urbane:.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

Dokumentat e tenderit.

**NJESIA E PROKURIMIT**

Daniela **Kukaj**

Arben **Manoku**

Florian **Kita**